

# RELACION TEKNIK

PARAPRAK

OBJEKTI:“ SHPIM PUSI NR.4/2024 PËR VADITJE BËNDA TERITORIT NË  
LULISHTEN E AMBASADËS GJERMANE”

POROSITËS: DREJTORIA E SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK, TIRANË

PROJEKTUES:“STUDIO PRIVATE PROJEKTIMESH STUDIMESH MONITORIMESH ARBI”



TIRANË PRILL 2024

## **A. Të përgjithshme**

Projekti teknik i shpimit të pusit është bërë nga **Studio Private Projektimesh Studimesh Monitorimesh ARBI**, pasi është shpallur fitues ne tenderin me numër procedure REF-00613-04-08-2024 i zhvilluar më dt.11/04/2024 nga **Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplloaik, Tiranë**, me titull procedure “Hartim studimi dhe projekt preventivi për shpim pusi uji në Ambasadës Gjermane”. Objekti ndodhet në rrugën Skënderbej (rruga e ambasadave), në krah të majtë të saj, në zonën kadastrale 45/17 Tiranë. Në bazë të detyrës së projektimit nga pusi i ujit Nr.4/2024 duhet të sigurohet prurja jo më pak se 2 l/sek (7.2m<sup>3</sup>/orë). Hapja e këtij pusi është e nevojshme për ujitjen e lulishtes të ambasadës dhe rezidencës së ambasadorit, duke qënë se kostoja e ujitjes ulet konsiderueshëm me furnizimin me ujë pusi, aktualisht furnizimi me ujë bëhet nga drejtoria Rajonale e Ujsjellës Kanalizime Tiranë.

## **B. Të dhënat e teknike të pusit Nr.4/2024 të projektuar në ambasadën Gjermane**

### **• Thellësia dhe diametri i shpimit të pusit.**

Pusi është projektuar deri në thellësinë 36m. Në fillim pusi do të shpohet me daltë me diametër Ø=400mm, deri në thellësinë 5m, për uljen e konduktorit me diametër Ø=330mm, me spesor δ=5mm, L=5m. Më pas shpimi do të bëhet me daltë me diametër Ø=320mm, për uljen e tubove të çelikut të galvanizuara me diametër Ø=193.7mm, δ=4mm deri në thellësinë 36m.

### **• Metoda e hapjes së pusit.**

Për shpimin e pusit metoda më e mirë është metoda e shpimit me rrotullim (rrotor) ose sondë hidraulike (top driver) dhe përdorimit të solucionit me argjile bentonite si lëng për pastrimin e tij. (Në rast se ka hapsirë të lirë, me kërkesë të investitorit të shikohet dhe varianti për shpimin e pusit me goditje).

### **• Armatosja e pusit me tuba dhe filtra**

Në pus do ulen tubo çeliku si më poshtë:

- 0÷5 m konduktori. tub çeliku me diameter Ø=330mm, δ=5mm;
- 0÷ 36 m tubo çeliku të galvanizuar me diameter Ø=193.7mm, δ=4mm;

Në puse në pakon e zhavorit do të ulen tubo çeliku të galvanizuara me filtra tip urë me diametër Ø=193.7mm. δ=4mm, në thellësinë 12÷20m dhe 22-26m;

### **• Zhvillimi i pusit**

Për larjen e pusit me kompresor, në pus do të përdoret kompresor me prodhueshmeri të ajrit 400 l/min,dhe me presion 10 atm. Zhvillimi i pusit me kompresor do të bëhet me dy metoda,me metodën e fryrjes nga lart poshtë dhe me metoden aeir lifte, për të pastruar trungun e pusit nga rëra dhe shllamrat që ndodhen brënda tij. Për zhvillimin e pusit me kompresor do të mjaftojnë 5 orë punë me të dyja metodat.

### **• Mbushja me zhavor**

Në pus në hapësira unazore ndërmjet trungut të pusit me diametër të shpimit 320 mm dhe tubove të çelikut të galvanizuar me diametër 193.7mm, në intervalin e thellësisë nga 5 deri në 36 m do të hidhet granil i marrë nga lumi me madhësi të kokërizave rreth 6-8mm. Sasia e granilit që do të hidhet në pus do të jetë rreth 2m<sup>3</sup>. Më pas do të bëhet çimentimi nga thellësia 5 m deri në sipërfaqen

e tokës. Çimentimi i grykës së pusit do të kryhet në hapësirën unazore ndërmjet tubave të çelikut të galvanizuara me diametër  $\varnothing=193.7\text{mm}$  dhe të konduktorit me diametër  $\varnothing=330\text{ mm}$ .

- ***Testimi i pusit***

Për vlerësimin e kapacitetit të pusit do të bëhet testimi i tij. Për testimin e pusit do të përdoret pompë zhytëse me debitdhënie 2 l/sek. Pompa do të ulet në thellësinë 30m. Testimi i pusit dotë bëhet vetëm me një prurje të pompës  $Q= 2\text{ l/sek}$ . Koha e pompimit për këtë prurje do të jetë jo më pak se 24 orë.

### ***C. Berja e grykës së pusit dhe linjat e shpërndarjes.***

Mbas mbarimit të shpimit të pusi Nr.4/2024 me të gjitha proceset e punës dhe të bëhet gryka e pusit. Gryka e pusit do të bëhet me pusetë betoni me përmasa 100x100x100, e mbuluar me kapak gize nga sipër, sipas projektit.

- ***Ulja e pompës në pusë.***

Me mbarimin e grykës së pusit me pusetë betoni, në pusë do të ulet pompë zhytëse me prurje  $Q= 2\text{ l/sek}$  (7.2 m<sup>3</sup>/orë) me hash  $H=40\text{m}$ . Pompa do te ulet me tubo manesman me diametër  $\varnothing=50\text{ mm}$ , në thellësinë 30m.

- ***Vendosja e rekorderive në grykën e pusit.***

Në grykën e pusit do të vendosen rekorderit njëra pas tjetrës si – brryl xingato 2",- nipël xingato 2",- kundra valvul xingato 2",- saraçineskë bronxi 2",- manikotë xingato 2" dhe bashkues plastikë 50/63, sipas projektit.

- ***Vendosja e tubave të dërgimit të ujit.***

Linja e dërgimit të ujit do të behet nga gryka e pusit deri tek depozitat e ujit, me tub PE 100, PN 10 atm, DN=63 mm. Tubi do të shtrihet në kanal me seksion tërthor të linjës 60x50 deri tek depozitat.

**PERGATIUR NGA: Studio private Projektimesh Studimesh Monitorimesh Arbi shpk**

**Ing. Irakli Dinaj**

